



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:208019
Datë: 26.11.2024
Numri i dokumentit: 06512314

C.nr.4889 /24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.K, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Taulant Ismajli, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensimi i pagës së 13-të, me vlerë të kontestit 901.74 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 26.11.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit I.K dhe DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, që në emër të shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore për vitin 2021, t'ia paguaj shumën prej 901.74 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 24.07.2024, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 24.07.2024, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës, për kompensimin e pagës së 13-të, me vlerë të kontestit 901.74 euro.

Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, ndërsa bazuar në nenin 29 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018, të njëjtit i takon shpërblimi për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore. Për realizimin e këtyre të drejtave, ka theksuar se i është drejtuar të paditurës me kërkesë, mirëpo nuk ka pranuar përgjigje. Gjykatës i ka propozuar që të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën në kompensimin e shumës prej 901.74 euro. Shpenzimet e procedurës i ka

kërkuar në mënyrë të specifikuar: 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 20.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se paga e trembëdhjetë mund të realizohet vetëm në momentin e aprovimit të buxhetit nga Ministria e Financave, për të cilën Ministria e Punëve të Brendshme - Policia e Kosovës ka bërë kërkesë për buxhet shtesë dhe i është refuzuar nga e njëjta. Ka theksuar se ky kompensim realizohet vetëm në bazë të mundësive ligjore por nuk përbën detyrim për të paditurën. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestues fakti se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data 19.09.2005 (vërtetimi nr.ref.10/01-SAP-P/11335 i dt.09.07.2024), ndërsa për vitin 2021 është vlerësuar me vlerësim plotësisht të kënaqshëm (formulari i vlerësimit të performancave për këtë vit) dhe është paguar në shumën prej 901.74 euro në muaj (vërtetimi si më lartë).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata gjeti se themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë që përcakton se “Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”; nenin 55, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 se “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (dt.14.11.2018), që në nenin 5, paragrafi 2 përcakton se “Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”; pika 2 e këtij se “Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”; si dhe nenin 29, paragrafi 2 se “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Zbatimi i këtyre dispozitave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të dt.09.10.2023.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13-të për çdo fundvit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi i performancës për vitin 2021, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Lidhur me pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi se të njëjtit nuk kanë mjete financiare për pagesën e kërkuar nga paditësi, për gjykatën një pretendim i tillë është jo relevant pasi që drejtat e kërkuara nga pala paditëse janë të parashikuara në udhëzimin administrativ, ndërsa e paditura në cilësinë e punëdhënësit duhet t'i përmbush obligimet që ka ndaj punëtorëve.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.4889/24, më datë 26.11.2024

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.